



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:079951

Datë: 03.05.2019

Numri i dokumentit: 00299214

P.nr. 237/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, ne çështjen penale ndaj të akuzuarit H... H.. nga fshati Zh... K. Gj... të cilin me autorizim e përfaqëson avokati....., për shkak të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.249/2019 të datës 28.02.2019, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 02.05.2019, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H... H... nga i ati Q... dhe e ëma I..., e lindur U..., i lindur më dt...., në Gj... , me vendbanim në fshatin Zh..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punon në në fshatin Zh..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, me nr. personal 1230154895, më parë i pa dënuar, dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 11.02.2019, rreth orës 13:15h, Zh... në oborrin e Q..., duke e pastruar oborrin e Qendrës ka mbledhur shishe plastike, letra dhe i ka ndezur, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë të rrezikshëm mund të shkaktoj rrezik për jetën e njerëzve apo shkaktimin e dëmit të konsiderueshëm material, duke menduar që nuk do të vij deri te kjo dhe pas ndezjes së zjarrit si pasojë e moskujdesit të tij është përhapur zjarri duke i përfshirë drunjtë e bredhit që ishin në distancë prej ...m, më pas zjarri ka filluar të përhapet dhe për shkak të rrezikut të përhapjes së zjarrit drejt objektit të Qendrës ka ardhur njësia e zjarrfikësve nga Gjilani dhe e kanë fikur zjarrin.

Me çka ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke ju referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit, në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 50, 51, 73, 74, 75 si dhe neneve 233 dhe 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarin,

E G J Y K O N

¹ **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** (Në tekstin e mëtejme **KPRK**), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

I. Të pandehurit....., i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditë, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit

IV. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 28.02.2019 ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të akuzuarittë cilin me autorizim e përfaqëson avokati, për shkak të veprës Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s. Po ashtu me datën 03.05.2019 në këtë gjykatë është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjiilan/Departamenti i përgjithshëm në njërën anë dhe në anën tjetër të pandehurit ...me mbrojtësin e tij av..... Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate i është rekomanduar, që ndaj të akuzuarit....., për shkak të veprës penale, ti shqiptohet dënim me kusht.

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 02.05.2019, gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij avokat....., se i akuzuari nuk ka qenë në asnjë mënyrë i detyruar apo i shtrenguar në asnjë mënyrë të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-s.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë penale, ekziston fakti se i akuzuari ...ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s., në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin....., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 të KPRK-s. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të akuzuaritt'i shqiptohet dënim me kusht, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të

cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 73 dhe 76 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se i akuzuari ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan / Departamenti i përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i akuzuari është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar dhe fakti që nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuarit me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese janë se vepra penale u krye me dashje dhe ankthi, dëmi i shkaktuar të dëmtuarit.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim kusht, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 2372019-Më 02.05.2019

Sekretarja juridike,
Fatmire Sermaxhaj d.v

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Ky aktgjykim është i formës së prerë, ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3. të KPPRK-s.